

123 | 2. 2011  
30.05.2011

## PROTOKOLLI

### PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ARTISTIK MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim: ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim: ASHSH), në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000, për vitet 2011-2013, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimtari të përbashkëta:

1. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërakademik. Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe -ASHSH (SSHSHA,IGJL - QSA);
2. Botimi i Hartës arkeologjike, II. Projekt i përbashkët i ASHAK (Muzeut të Kosovës) dhe ASHSH (SSHSHA, IA – QSA), 2011;
3. Botimi i librit "Mbrojtja e pemëve dhe hardhisë", ASHSH (SSHN) dhe ASHAK (SSHN), 2012;
4. Fjalor përkufizues i termave të informatikës (Anglisht – Shqip). Hartimi dhe botimi i Fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSHNT, IGJL – QSA, Fakulteti i teknologjive të Informacionit, Qendra e Teknologjive të Informacionit - UPT), 2011 e në vazhdim;
5. Fjalor shpjegues për mjedisin, ASHSH (SSHNT,QSA) dhe ASHAK (SGJL), 2011 e në vazhdim;
6. Konferencë shkencore "Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë në kuadrin e integrimeve rajonale e më gjerë", ASHSH dhe ASHAK. Tiranë, 2012;
7. Konferencë shkencore: "Studime albanistike", ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2012;
8. "Konferencë Shkencore e Algjebraës dhe e Analizës Funksionale" organizuar nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit, ASHSH (SSHNT) dhe ASHAK (SSHN), Elbasan, 2012;
9. Konferencë shkencore "Letërsia pas diktaturës", ASHAK (SGJL) dhe -ASHSH (SSHSHA,QSA) Tiranë 2013;
10. Konferencat shkencore në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë: "Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas" ASHAK (SSHSH dhe IHK) dhe ASHSH (SSHSHA, QSA), Tiranë, Prishtinë 2012;
11. Tryezë shkencore "Për kritikën letrare", ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Tiranë 2011-2013;
12. Sesion shkencor "Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit" ASHAK (SGJL) dhe -ASHSH (SSHSHA,QSA), Pishtinë 2011;

**13. Sesion shkencor "Gjendja e kritikës muzikore ndër shqiptarë", ASHAK (SA) dhe ASHSH, Prishtinë 2012;**

**14. Projekti: "Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë", ASHAK (SSHN) në bashkëpunim me ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT), 2011 e në vazhdim;**

**15. Projekt "Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri" ASHSH (SSHNT; FSHN - UT; UBT) dhe ASHAK (SSHN), 2011 e në vazhdim;**

**16. Ekspeditë e përbashkët për mbledhjen e lëndës folklorike, etnologjike gjuhësore në trevat e paeksploruara sa duhet. ASHAK (IAP-i) dhe ASHSH (SSHSNA, QSA), 2011 e në vazhdim;**

**17. Promovime veprash shkencore, ASHAK dhe ASHSH, 2011 e në vazhdim;**

**18. Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore, ASHAK dhe ASHSH 2011 e në vazhdim;**

**19. Ligjérata të ndërsjella të akademikëve, ASHAK dhe ASHSH, 2011 e në vazhdim.**

Për secilën prej veprimitarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimitarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.


Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të burimeve financiare.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.

Nënshkruar në Prishtinë, më 30 maj 2011, në dy kopje, me përbajtje dhe vlerë të njëjtë.


**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
TË SHQIPËRISË**

**Zëvendëskryetari**

  
Akademik Muzafer Korkuti

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

**Nënkyetari**

  
Akademik Hivzi Islami

Prot. 110  
13.06.2013

Nr. 117  
Dt. 14. 6. 2013

PROTOKOLLI

PRISHTINË

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-  
SHKENCOR DHE ARTISTIK NDËRMJET AKADEMISË SË SHKENCAVE TË  
SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË  
KOSOVËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim: ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim: ASHAK) në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik të vitit 2000, përvit 2013-2015, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimitari të përbashkëta:

1. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimitari e Këshillit Ndërakademik të gjuhës shqipe. Bashkëpunim i vazdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe -ASHSH (SSHSHA, IGJL - QSA);
2. Konferencë shkencore ndërkombëtare *F. S. Noli - gjeniu i kulturës shqiptare të shekullit XX* (Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes) - Tiranë, 2015;
3. Konferencë shkencore për studimet albanologjike, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2014;
4. Konferencë shkencore *Luftha e Parë Botërore 1914 dhe çështja shqiptare*, ASHAK (SSHSH, IHP) në bashkëpunim me ASHSH, Prishtinë 2014;
5. Tryezë shkencore *Arkeologja në trojet shqiptare-sfidat dhe mundësità*, ASHAK-ASHSH, Prishtinë 2014;
6. Projekt: *Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë*, ASHAK (SSHN) dhe ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT), 2013 e në vazhdim;
7. Hartimi i monografisë "Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve" bazuar në studimin e Projektit: "Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri" (2009 – 2013) ASHSH (SSHNT; FSHN - UT; UBT; QTTB; Vlorë, MBUMK) dhe ASHAK (SShN), 2013 e në vazhdim. (Botimi do të realizohet nga ASHSH).
8. Promovime veprash shkencore, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim;
9. Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim;
10. Ligjërata të ndërsjella të akademikëve, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim.

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të burimeve financiare.


Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.

Nënshkruar në Tiranë, më 13 qershori 2013, në dy kopje, me përbajtje dhe vlerë të njëjtë.


PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
TË SHQIPËRISË

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË  
ARTEVE TË KOSOVËS

AKADEMIK SALVATOR BUSHATI



AKADEMIK ISUF KRASNIQI



Tiranë, më 13 qershori 2013